



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



ZKA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË MINISTRISË SË BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL PËR VITIN 2024

Prishtinë, qershor 2025

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Çështjet e zgjidhura gjatë procesit të auditimit
- 4 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2024, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZhR), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për Opinion të Kualifikuar

- C1 Vlera e pasurive kapitale e prezantuar në PFV ishte e nënvlerësuar për 1,184,104€, ndërsa regjistri i pasurive jo kapitale ishte nënvlerësuar për 17,473€, si pasojë e pasurive të pa regjistruara dhe mos korigjimit të vlerës së pasurive të ri vlerësuar.
- B1 Gjashtë pagesa të ekzekutuara sipas vendimeve gjyqësore në vlerë të përbashkët 95,179€ janë paguar nga kategoria jo-adekuate ekonomike.
- A1 Gjendja e llogarive të arkëtueshme në pasqyra financiare ishte e mbivlerësuar për 237,013€.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Në kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- C2 Projekti "Ndërtimi, rehabilitimi dhe zgjerimi i sistemit të ujitjes në komunat Mitrovicë, Vushtrri, Kamenicë, Shtime, Klinë, Istog, Deçan dhe Junik" nuk ka arritur të realizohet në tërësi dhe të funksionalizohet në të gjitha llojet, për shkak të problemeve në planifikim. Vlera e pagesave të realizuara për këtë projekt ishte 1,476,624€.
- A2 Në gjashtë (6) raste të pagesave për grante në vlerë të përbashkët prej 358,259€ kishte vonesa në pagesa prej 17 deri në 89 ditë përtej afatit të lejuar me vendim.
- A3 Në kontratën "Furnizim me uniforma për inspektorët e AUV", në vlerë 47,045€, kishte mangësi në menaxhimin dhe ekzekutimin e kontratës në përputhje me kushtet e kontraktuar.
- A4 Në kontratën "Shërbime profesionale inxhinierike për nevoja të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë" në vlerë 21,566€ kishte mangësi në aplikimin e procedurës adekuate të prokurimit e cila ka ndikuar edhe në procesin e pagesës.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.

- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Fushat që kërkojnë përmirësim të mëtutjeshëm janë menaxhimi i pasurisë me theks të veçantë regjistrimi i plotë dhe i saktë i pasurive kapitale, klasifikimi adekuat i shpenzimeve si dhe shpalosja e vlerës së saktë të llogarive të arkëtueshme.

Sa i përket pajtueshmërisë me legjislacionin dhe rregulloret e zbatueshme, fokus më i madh duhet t'i kushtohet shmangies së vonesave në pagesat e granteve, menaxhimit më efikas të kontratave brenda kohëzgjatjes dhe qëllimit të tyre si dhe evitimit të mangësive në fushën e prokurimit.

Ky raport ka rezultuar me tetë (8) rekomandime, prej tyre pesë (5) janë rekomandime të reja, një (1) rekomandim i përsëritur dhe dy (2) rekomandime pjesërisht të përsëritura. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 5.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja C1 - Mangësi në menaxhimin e pasurive jo financiare

Gjetja

Rregullorja MFNR 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, Neni 6.1 përcakton se, çdo organizatë buxhetore duhet të krijoj dhe azhurnoj regjistrin e pasurive jo financiare që i ka në menaxhimin e saj. Regjistri duhet të mbahet ndaras për çdo pasuri dhe në formë të agreguar sipas kategorive të klasifikuara në bazë të planit kontabël. Si dhe neni 6.3 përcakton se, pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohen në sistemin e-pasuria.

Ne kemi identifikuar disa mangësi sa i përket mbajtjes së regjistrave të pasurive, të cilat kanë ndikuar që regjistri i pasurive kapitale të nënvlerësohet për 1,184,104€ si pasojë e mos korrigjimit të vlerës së pasurive të ri-vlerësuara, mos regjistrimit dhe gabimeve në regjistrimin e pasurisë, si dhe regjistri i pasurive jo kapitale të nënvlerësohet për 17,473€ si pasojë e mos regjistrimit të pasurive jo kapitale.

Mangësitë e identifikuar janë si në vijim:

- Si rezultat i zbatimit të rekomandimit të viteve të fundit, ministria ka nënshkruar kontratën me kompaninë për vlerësimin financiar të pronave dhe asetëve të paluajtshme të Institutit Bujqësor të Kosovës (IBK) më 13.02.2024. Nga 129 prona të vlerësuara, gjashtë (6) ishin rrugë, për të cilat kompania vlerësuese nuk ka mundur të jap një vlerë financiare prandaj i ka raportuar me vlerë financiare zero. Këto prona, të cilësuar si rrugë, nuk janë evidentuar në regjistrat e

pasurive të ministrisë pavarësisht se ato janë pronë e saj. Krahas kësaj, kompania e vlerësimit financiar të pronës, ndër të tjera, ka rivlerësuar edhe 13 objekte ndërtimore të cilat gjinden në këto prona, dhe si rezultat u ishte rritur vlera për 997,267€ krahasuar me vlerën paraprake. Ministria nuk ka korigjuar vlerën në regjistrin e pasurive, dhe vlera aktuale e këtyre asetëve bazohet në vlerësimin e bërë në vitin 2016. Si rezultat, regjistri i pasurisë kapitale ishte nënvlerësuar për të njejtën vlerë;

- PAGESA lidhur me hartimin e projektit për ndërtimin e ndërtesës për MBPZhR-së, Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë (AZhB) dhe Agjencisë së Pyjeve të Kosovës (APK) në vlerë 200,000€ nuk ishte regjistruar në regjistrin e pasurive kapitale e cila kishte shkaktuar nënvlerësimin për të njejtën vlerë;
- Në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV), nuk ishte regjistruar në regjistrin e pasurive kapitale pagesa për hartimin e projektit për dy zyra regjionale në vlerë 11,136€ duke nënvlerësuar regjistrin për të njejtën vlerë;
- Në AUV, pagesa për softuerin në vlerë 26,999€ ishte kategorizuar gabimisht si investim në vijim dhe si pasojë e mos llogaritjes së zhvlerësimit nga viti 2016 regjistri i pasurive në SIMFK ishte mbivlerësuar për 24,299€; si dhe
- Në AUV, pesë (5) pagesa për pasuritë jo kapitale në vlerë të përbashkët 17,473€ nuk janë regjistruar në sistemin e-pasuria.

Kjo ishte rezultat i një sistemi jo efektiv të kontrolleve dhe mungesës së një procedure të rregullt për përditësimin e vlerës së pasurive në rast rivlerësimi. Mos regjistrimi i pasurive jo kapitale në sistemin e-pasuria në AUV ka ndodhur për shkak të mungesës së një mekanizmi për sigurimin e vazhdimësisë së procesit gjatë periudhave të mungesës së zyrtarëve .

Ndikimi

Gabimet në regjistrim, mos regjistrimi i plotë dhe i drejtë i pasurisë sipas kriterëve të përcaktuara në rregullore për menaxhimin e pasurisë jo financiare, kanë ndikuar në mbivlerësimin/nënvlerësimin e regjistrave të pasurive si dhe në prezantimin e informatave jo të sakta të pasurive në PFV.

Rekomandimi C1

Ministri, në bashkëpunim me Drejtorin e AUV-së, duhet të përforcojnë kontrollet e brendshme në menaxhimin e pasurisë, duke siguruar regjistrimin dhe korigjimin e pasurive jo financiare sipas vlerave të sakta. Kjo do të mundësojë që gjendja e pasurive e prezantuar në pasqyrat financiare të jetë e plotë dhe e saktë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B1 - Klasifikim jo adekuat i shpenzimeve

Gjetja

Sipas rregullës financiare Nr. 01/2013, neni 18.3 Shpenzimi i parave publike, shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me planin kontabël. Po ashtu, me Udhëzuesin e planit kontabël - Dhjetor 2023, janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB duhet ti aplikojnë.

Si rezultat i pagesave të ekzekutuara sipas vendimeve gjyqësore, kishte keq klasifikim të shpenzimeve në vlerë prej 95,179€. Lidhur me këtë, nga

mostrat e testuara kemi identifikuar:

- Nga kategoria e investimeve kapitale ishin paguar 11,573€. Borxhi kryesor ishte 6,720€ i cili për nga natyra i takon kategorisë së subvencioneve dhe transfereve sepse ka të bëjë me financim të projekteve investuese të zhvillimit rural, ndërsa mjetet në vlerë 4,853€ ishin paguar si shpenzime të interesit si dhe shpenzime procedurale të gjykatës/përmbartimit të cilat i takonin kategorisë së mallrave dhe shërbimeve.
- Katër (4) pagesa në vlerë të përbashkët 86,651€ ishin paguar nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve ndërsa kishin të bënin me shpenzime të kategorisë së pagave dhe medijëve. Nga vlera e realizuar, borxhi kryesor prej 75,606€ ishte paguar nga kategoria jo adekuate.
- Po ashtu, pagesa në vlerë 11,796€ ishte paguar nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve, përderisa për nga natyra i takon kategorisë së subvencioneve dhe transfereve. Rrjedhimisht, borxhi kryesor prej 8,000€ ishte paguar nga kategoria jo adekuate.

Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve ka ndodhur si rezultat i kontrolleve jo të mjaftueshme me rastin e planifikimit, ekzekutimit dhe mbikëqyrjes së shpenzimeve.

Ndikimi

Pagesat e kryera nga kategoria jo adekuate e shpenzimeve ndikojnë në mbivlerësim/nënvlerësim të kategorive përkatëse të shpenzimeve dhe rrjedhimisht në paraqitje jo të saktë dhe të drejtë të shpenzimeve në PVF.

Rekomandimi B1

Ministri duhet të sigurojë se janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që pagesat dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhen në kodet përkatëse ekonomike sipas planit kontabël, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre në PFV. Nëse planifikimet buxhetore nuk përkrijnë me natyrën e shpenzimit dhe nevojat e ministrisë, duhet të bëhet ridestini i mjeteve me qëllim të sigurimit të fondeve për pagesën e rregullt të shpenzimeve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A1 - Shpalosje e llogarive të arkëtueshme jo në përputhje me dokumentet burimore

Gjetja

Sipas nenit 16 të Rregullores së MF Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore: “OB që mbledhin të hyra, janë të detyruara të mbajnë regjistra të të hyrave të mbledhura dhe shumat e faturuara e të pa arkëtuara”.

Në një rast të testimi të llogarive të arkëtueshme që ka të bëjë me kontratë për “Shfrytëzimin e përkohshëm të tokave pyjore” në Agjencinë e Pyjeve të Kosovës (APK), kemi identifikuar se nuk kishte evidencë të saktë lidhur me prezantimin në PFV të vlerës së llogarive të arkëtueshme përkatësisht të obligimeve financiare të qiramarrësit të tokës pyjore. Sipas dokumenteve burimore të ofruara nga APK, kartelës financiare dhe informacionit të siguruar nga zyrtarët përgjegjës, rezultoi se qiramarrësi ka një obligim financiar ndaj APK-së prej 12,793€, ndërsa në pasqyra financiare është shpalosur vlera 249.806€. Rrjedhimisht llogaritë e arkëtueshme janë mbivlerësuar për 237,013€.

Kjo ka ndodhur për shkak të mungesës së kontrolleve adekuate në paraqitjen dhe azhurnimin e regjistrave të llogarive të arkëtueshme në përputhje me dokumentet burimore.

- Ndikimi** Prezantimi i llogarive të arkëtueshme në vlera jo të sakta ndikon që palët e interesit apo shfrytëzuesit e PVF-ve të mos informohen drejtë dhe saktë lidhur me vlerën e tyre.
- Rekomandimi A1** Ministri, dhe Drejtori i APK-së, duhet të sigurojnë se është rishikuar sistemi i kontrolleve të brendshme lidhur me mbajtjen e regjistrave të llogarive të arkëtueshme. Ky rishikim do të siguroj forcimin e kontrolleve të brendshme dhe monitorim të rregullt të të dhënave financiare në mënyrë që të parandalohen gabimet dhe llogaritë e arkëtueshme të prezantohen në vlera të sakta dhe të mbështetura në dokumente burimore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja C2 - Ndërprerje dhe mos funksionalizim i projektit si pasojë e problemeve në planifikim

Gjetja

Kontratat e nënshkruara në mes MBPZhR-së dhe Operatorëve ekonomik për tetë (8) lote në kuadër të projektit: “Ndërtimi, rehabilitimi dhe zgjerimi i sistemit të ujitjes në komunat Mitrovicë, Vushtrri, Kamenicë, Shtime, Klinë, Istog, Deçan dhe Junik” në vlerë të përbashkët prej 2,196,484€, në kushtet e veçanta të kontratës (KVK) parasheh se data e përfundimit të të gjitha punëve do të jetë 85 ditë kalendarike ashtu siç është specifikuar edhe në dosjen e tenderit. Po ashtu, Kushtet e përgjithshme të këtyre kontratave, përkatësisht nenet 33-35 rregullojnë procedurat e pranimit të përkohshëm dhe përfundimtar të punëve si dhe përgjegjësinë mbi defektet.

Gjatë auditimit kemi konstatuar se projekti nuk ka arritur të realizohet në tërësi dhe të funksionalizohet në të gjitha llotet, për shkak të problemeve në planifikim të cilat kanë ndikuar edhe në implementim të projektit. Deri në përfundim të auditimit progresi për secilën kontratë është evidentuar si në vijim:

- Në Komunën e Mitrovicës, Vushtrrisë, Istogut dhe Klinës sipas raportit përfundimtar të komisionit për menaxhim të kontratave dhe të kompanisë mbikëqyrëse punimet ishin ndërprerë me marrëveshje në mes të dy palëve pa u përmbushur kontrata, pasi që për shkak të problemeve të shumta që janë hasur gjatë ekzekutimit, ishte i pa mundur realizimi i projektit. Vlera e përbashkët e kontratave për punë në këto komuna ishte 1,091,670€, ndërsa gjithsej ishin shpezuar 660,275€;
- Në Komunën e Kamenicës nuk ka qenë e mundur as të fillojnë punimet dhe kontrata është ndërprerë pa u realizuar asnjë pagesë; ndërsa
- Në Komunën e Deçanit, Junikut dhe Shtimes, përkundër problemeve dhe vonesave në realizim, punimet kishin përfunduar por ende nuk ishin finalizuar procedurat e pranimit përfundimtar të punëve. Vlera e përbashkët e kontratave për punë në këto komuna ishte 871,857€, ndërsa gjithsej ishin shpezuar 816,348€.

Kjo ishte rezultat i inicimit dhe kontraktimit të projektit nga ministria pa u bërë një analizë e mirëfilltë nga komunat e bazuar në gjendjen në terren me paramasë dhe paralogari të saktë. Kjo ka shkaktuar probleme të shumta gjatë zbatimit të projektit, si: mospërshtatje të dizajnit me paramasën, pengesa nga banorët lokal, probleme pronësore nga fermerët dhe mos lejim i kyçjes në sistemin e ujitjes të Ibër-Lepencit për shkak të mospërmbushjes së kërkesave nga komunat.

Ndikimi

Mos funksionalizimi i projektit ndikon në mos arritjen e qëllimit të mbështetjes financiare nga ministria si dhe në humbje financiare për projekte të dështuara.

Rekomandimi C2

Ministri duhet të siguroj se është bërë një rivlerësim i mënyrës së menaxhimit të projektit, rezultatet e të cilit do të shërbejnë në krijimin e një strukture të qëndrueshme për analiza fillestare dhe planifikim të detajuar të mundësive dhe burimeve që do të mundësojnë realizimin e plotë të

projekteve të ardhëshme.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Vonesa në realizimin e pagesave për grante

Gjetja

Me vendimet e lëshuara për mbështetje nga Programi i Zhvillimit Rural, përkatësisht pika 7 e secilit vendim të lëshuar, përcakton se shuma e përkrahjes publike për ekzekutim sipas vendimit, duhet të transferohet në logari të përfituesit në afat prej 30 ditësh.

Në gjashtë (6) raste të indentifikuara, pagesat për përfituesit nga Programi për Zhvillimin Rural janë vonuar nga 17 deri në 89 ditë pas afatit të përcaktuar me vendim. Vonesat janë si në vijim:

- MASA 1 - Investimet në asetet fizike të ekonomive bujqësore, sektori 1.6 Prodhimi i mishit/rritja e derrave, vendimi është miratuar me 20.12.2023, kurse pagesa në vlerë 11,021€ është realizuar me 17.04.2024, me një vonesë në pagesë për 89 ditë;
- MASA 1 - Investimet në asetet fizike të ekonomive bujqësore, sektori 1.1 Pemë drufrutore, vendimi është miratuar me 21.12.2023, kurse pagesa në vlerë 64,738€ është realizuar me 18.04.2024, me një vonesë në pagesë për 89 ditë;
- MASA 3 - Investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore, sektori 3.3 Përpunimi i mishit të shpezëve/investime në thertore, vendimi është miratuar me 19.12.2023, kurse pagesa në vlerë 99,734 është realizuar me 04.04.2024, me një vonesë në pagesë për 77 ditë;
- MASA 7 - Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve, sektori 7.2 Zhvillimi i turizmit, vendimi është miratuar me 22.12.2023, kurse pagesa në vlerë 58,836€ është realizuar me 04.04.2024, me një vonesë në pagesë për 74 ditë;
- MASA 1 - Investimet në asetet fizike të ekonomive bujqësore, sektori 1.7 - Prodhimi i qumështit /Lopë, vendimi është miratuar me 23.10.2024, kurse pagesa në vlerë 63,930€ është realizuar me 26.12.2024, me një vonesë në pagesë për 34 ditë; dhe
- MASA 7 - Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve, sektori 7.1- Grumbullimi dhe përpunimi i produkteve jo drusore të pyllit përfshirë bimët mjekësore dhe aromatike, vendimi është miratuar me 03.10.2024, kurse pagesa në vlerë 60,000€, është realizuar me 19.11.2024, me një vonesë në pagesë për 17 ditë.

Vonesat në ekzekutimin e pagesave pas afatit të përcaktuar janë rezultat i mungesës së një sistemi efektiv të kontrollit në menaxhmin e pagesave për grante.

Ndikimi

Vonesat në realizimin e pagesave mund të shkaktojnë rritje të mundshme të kostove, si dhe shtyrje të afatit të planifikuar për realizim të projektit.

Rekomandimi A2

Ministri, në bashkëpunim me Kryeshefin Ekzekutiv të AZhB-së, duhet të siguroj kontrole më efektive të procedimit të pagesave në mënyrë që të gjitha vendimet e miratuara për ekzekutim të pagesave për përfituesit të realizohen brenda afatit të përcaktuar ligjor.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A3 - Mangësi në menaxhim dhe ekzekutim të kontratës**Gjetja**

Bazuar në Rregulloren nr.001/2022 për prokurimin publik, neni 71.1 "Ndryshimi i kontratës i referohet një ndryshimi në termat dhe kushtet e një kontratë të shpërblyer. Ndryshimi i kontratës iniciohet nga Menaxheri i kontratës. Në rast të kontratave për punë nevojitet aprovimi paraprak i projektuesit. Aty ku ndryshohet kontrata me qëllim të ndryshimit të termave dhe kushteve fillestare, ndryshimi i kontratës do të përgatitet nga departamenti i prokurimit. Ndryshimi i kontratës nuk do t'i lëshohet Operatorit ekonomik para: Marrjes së aprovimit nga ZKA. Po ashtu, neni 29.6 i kësaj rregullore thekson se Sigurimi i ekzekutimit do të mbetet valid për një periudhë prej tridhjetë (30) ditë pas kompletimit të kontratës. Ndërsa, neni 16.1 i kontratës parasheh aplikimin e dëmeve të likuiduara për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, të barabartë me 0.25% në ditë të vlerës së furnizimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10% të vlerës totale të kontratës.

Tek kontrata "Furnizim me uniforma për inspektorët e AUV", në vlerë 47,045€, afati i kontratës ishte vazhduar për 60 ditë pas skadimit të saj më date 28.08.2024, nëpërmjet një aneks kontrate të nënshkruar nga menaxheri i prokurimit, bazuar në kërkesën e operatorit ekonomik. Ky veprim është kryer pa inicim të kërkesës nga menaxheri i kontratës dhe pa aprovim paraprak nga Drejtori Ekzekutiv i AUV-së. Aneks kontrata nuk ishte e protokoluar dhe nuk ishte e vendosur tek platforma e prokurimit publik.

Operatori ekonomik nuk e kishte përmbushur plotësisht kontratën, duke lënë pa furnizuar mallra në vlerë prej 3,880€, pa ofruar ndonjë arsytim të dokumentuar për mosfurnizimin. Mallrat ishin pranuar nga një komision i dytë pas refuzimit të pranimit të mallit dy herë nga komisioni i parë për shkak të mospërputhjes me specifikat e përcaktuara në kontratë. AUV nuk i kishte aplikuar penalizim operatorit ekonomik për vonesat në dorëzim, edhe pse afati i paraparë në kontratë ishte tejkaluar, dhe as nuk kishte kërkuar vazhdimin e sigurisë së ekzekutimit. Siguria e ekzekutimit kishte skaduar me 27.08.2024, ndërsa furnizimi i mallrave ishte realizuar me 18.10.2024.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mos zbatimit të një monitorimi të duhur për të siguruar që kontrata po përmbushet në përputhje me afatet dhe kushtet e kontratës.

Ndikimi

Mungesa e një mbikëqyrjeje të vazhdueshme mund të çojë në moszbatimin e kërkesave për transparencë dhe përmbushje të detyrimeve kontraktuale, duke pamundësuar ndjekjen e procedurave të parashikuara për monitorimin e kontratave dhe zbatimin e rregulloreve që lidhen me vonesat dhe mosrealizimin e detyrimeve kontraktuale. Për më tej, mos aplikimi i penalizimeve dhe implementimi i kontratës në mungesë të sigurisë së ekzekutimit përveç që është mos-zbatim i kushteve kontraktuale, rrit rrezikun që humbjet eventuale për ekzekutimin e kontratës të mos mbulohen me një garancion.

Rekomandimi A3

Ministri, në bashkëpunim me Drejtorin e AUV-së, duhet të forcojë kontrollet dhe mbikëqyrjen e zbatimit të kontratave duke siguruar që çdo aneks

kontratë të miratohet nga autoritetet përgjegjëse me dokumentim të rregullt, penalizimet të zbatohen ndaj operatorëve që nuk përmbushin detyrimet si dhe siguria e ekzekutimit të jetë e vlefshme deri në përfundimin e plotë të kontratës për të minimizuar humbjet financiare.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A4 - Mangësi në aplikimin e kontratës kornizë

Gjetja

Sipas Rregullores 001/2022 për prokurim publik, neni 17.34 specifikon “Në rast të aplikimit të kontratës kornizë ku sasi të mund të mos jenë parashikuar në mënyrë precize një parashikim i përafërt i sasive duhet të përfshihet. Parashikimi i tillë i përafërt mund të bazohet në konsumin e mëhershëm duke e korrigjuar me variacionet e njohura sipas nevojës. Sasi të duhet të kenë për aq sa është e mundur afatet e dorëzimit”.

AUV kishte nënshkruar kontratën publike kornizë “Shërbime profesionale inxhinierike për nevoja të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV)” në vlerë 21,566€ dhe me kohëzgjatje tri vjeçare. Kjo kontratë përbëhej nga dy pjesë: Shërbime të projektimit në vlerë 8,566€; si dhe Shërbime të mbikëqyrjes së punimeve ndërtimore në vlerë 13,000€.

Gjatë ekzaminimit të dosjes së prokurimit dhe pagesës, u identifikuan mangësi në zgjedhjen e procedurës adekuate të prokurimit që ka ndikuar edhe në procesin e pagesës.

Njësia kërkuese e AUV-së kishte parashtruar kërkesë për ndërtimin e dy zyreve regjionale në Ferizaj dhe Gjakovë, të cilat duhej të ishin identike me projektin ekzistues të projektuar nga Komisioni Evropian (KE). Për këtë shërbim është aplikuar kontrata kornizë me devijim të lejuar +/- 30%, edhe pse sasi të kontraktuara nuk ishin indikative por të përcaktuara saktë, pra çmimi për çdo pozicion të shërbimeve të projektimit ishte ofertuar për sasi të sipërfaqës së projektuar e cila ishte precize dhe e përcaktuar. Pavarësisht kësaj operatorit ekonomik i është aprovuar edhe kompensim për punë shtesë për pozicione që nuk ishin të kontraktuara, duke e rritur vlerën e shërbimeve të projektimit me 30%, rrjedhimisht vlera e realizuar e pagesës për shërbime të projektimit ishte 11,136€.

Kjo situatë ishte rezultat i përdorimit të llojit të gabuar të kontratës e cila ka ndikuar edhe në procesin e pagesës.

Ndikimi

Përdorimi i kontratës kornizë, megjithëse sasi të dhe çmimet ishin përcaktuar saktë, ka çuar në një rritje të panevojshme të kostos së projektimit deri në kufirin maksimal të lejuar prej 30%, përmes miratimit të punëve shtesë për pozicione që nuk ishin të parashikuara në kontratë, gjë që nuk është e lejuar sipas këtij lloji të kontratës.

Rekomandimi A4

Ministri dhe Drejtori i AUV-së duhet të sigurojnë që në rastet e procedurave të tilla të aplikohen kontratat adekuate me qëllim të shfrytëzimit sa më efikas të fondeve dhe evitimit të mënyrave të pa lejuara të pagesës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 124,204,371€, pasurive jokapitale është 278,258€, si dhe e stoqeve 155,391€.

Çështja A5 - Mos inventarizimi i pasurive në AZhB

Gjetja

Rregullorja MF NR 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, neni 4.6 përcakton se Zyrtari Kryesor Administrativ themelon Komisionin për Vlerësim të Pasurisë jo Financiare dhe Komisionin për Inventarizimin e pasurisë jo financiare.

Ministria ka realizuar procesin e inventarizimit të pasurive në fund të vitit, ndërsa AZHB, e cila shërbimin financiar e ka të decentralizuar nga ministria që nga fillimi i vitit 2024, nuk kishte themeluar komisionin dhe nuk kishte kryer procesin e inventarizimit të pasurive të saj.

Arsyeja e mos inventarizimit të pasurive nga AZhB ishte mungesa e qartësisë në lidhje me detyrimet dhe përgjegjësitë për të kryer një inventarizim të pavarur.

Ndikimi

Mos kryerja e këtij procesi ndikon në ofrimin e sigurisë lidhur me menaxhimin e pasurive, dhe pasqyrimin të saktë të gjendjes së pasurive në pasqyrat financiare.

Rekomandimi A5

Ministri, dhe Kryeshefi i AZhB-së, duhet të ndërmarrin veprime për të formuar me kohë komisionin për inventarizimin vjetor apo periodik të pasurive jo financiare, si dhe të gjitha ndryshimet në numrin ose vlerën e pasurive të cilat rezultojnë nga ky proces duhet të pasqyrohen saktë në regjistrin e pasurive.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Çështjet e zgjidhura gjatë procesit të auditimit

Gjatë rishikimit të PFV-ve u identifikuan disa gabime që iu komunikuan menaxhmentit dhe u zgjidhen në mënyrë efektive gjatë auditimit. Kjo çështje nuk kërkon ndonjë veprim të mëtutjeshëm dhe raportohet vetëm me qëllim të dokumentimit të komunikimit në fjalë, veprimeve të ndërmarra dhe rezultateve të tyre.

Çështja materiale e identifikuar dhe e përmirësuar gjatë kohës së auditimit është paraqitur si më poshtë:

Çështja 1

Paraqitje jo e saktë e të hyrave të pranuar nga donatorët në PVF

Gjetja

Në Pasqyrat Financiare Vjetore të MBPZhR-së për vitin 2024, "Grantet e përcaktuara të donatorëve (shënimi 11)", tek Neni 14 - "Raporti i ekzekutimit të buxhetit - Hyrja e parasë së gatshme", nuk ishin paraqitur saktë tek kolona e realizimit. Vlera e të hyrave të realizuara nga donatorët për vitin 2024 ishte 200,880€ ndërsa në PFV ishin paraqitur në vlerë 1,025,879€, pra kishte mbivlerësim të vlerës së paraqitur për 824,999€. Kjo ka ndikuar edhe në prezantimin jo të saktë të Shënimit 11 "Grantet e përcaktuara të donatorëve" dhe tek Neni 24 "Raport për fondet e donatorëve të pa-shpenzuara".

Veprimi i kërkuar

Rishikimi fillestar i PFV-ve të ministrisë, ka vënë në pah nevojën për korrigjim të këtyre gabimeve për shkak të ndikimit material që do të kishte mos-korrigjimi i tyre.

Rezultati

Këto gabime janë korrigjuar nga entiteti pas diskutimit me ekipin e auditimit dhe në përputhje me afatin e miratuar nga Thesari për lejim të korrigjimeve.

4 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁵	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
Burimet e fondeve	89,833,563	97,764,311	94,950,196	91,094,842	77,257,371
Grante Qeveritare - Buxheti	89,489,722	95,084,509	93,679,545	90,705,258	74,545,887
Financimi përmes huamarrjes	0	0	0	0	1,126,009
Financimi përmes huamarrjes - klauzola e investimeve	0	0	0	0	1,526,931
Të bartura nga viti i kaluar	0	147,473	142,717	183,155	58,544
Të hyrat vetanake	343,841	343,841	102,055	196,368	0
Donacionet e jashtme	0	2,188,487	1,025,879	10,061	0

Buxheti final i MBPZhR-së në raport me buxhetin fillestar është rritur për 7,930,748€. Ky ndryshim është rezultat i vendimeve të Qeverisë për ndarje buxhetore, përfshirjes së të hyrave të bartura nga viti i kaluar, të hyrave të pranuar nga fondet e donatorëve si dhe shkurtimeve buxhetore me vendime Qeveritare.

Në vitin 2024, MBPZhR, ka shpenzuar 97% të buxhetit final ose 94,950,196€, pra në përqindje të njëjtë krahasuar me vitin pararpak. Të dhënat e vitit 2022 nuk përfshijnë të dhënat e AUV-së e cila ishte pjesë e Zyrës së Kryeministrit (ZKM) në atë vit, prandaj krahasimi i performancës me vitet paraprake nuk paraqet matje reale.

Shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	89,833,563	97,764,311	94,950,196	91,094,842	77,257,371
Pagat dhe mëditjet	7,187,303	6,005,013	6,005,013	4,966,809	2,458,724
Mallrat dhe shërbimet	6,410,455	7,358,481	6,273,567	3,401,056	2,404,100
Komunalitë	314,783	179,961	131,889	119,715	56,367
Subvencionet dhe transferet	72,097,022	81,597,022	81,221,473	81,492,355	70,262,987
Investimet Kapitale	3,824,000	2,623,834	1,318,253	1,114,906	2,075,193

Buxheti final për paga dhe mëditje në raport me buxhetin fillestar është zvogëluar për 1,182,290€. Ky ndryshim ishte rezultat i të hyrave nga fondet e donatorëve në vlerë 8,400€ (në AUV), si dhe zvogëlimit të mjeteve me vendime të Qeverisë në vlerë 1,190,690€. Shpenzimi në këtë kategori në raport me buxhetin final ishte 100%.


Buxheti final për mallra dhe shërbime në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur për 948,026€. Ky ndryshim ishte rezultat i alokimit të të hyrave të bartura nga viti i kaluar në vlerë 147,473€ (në APK dhe AUV), të hyrat nga grantet e donatorëve në vlerë 571,085€, rritje nga transferi i mjeteve nga kategoria subvencione dhe transfere në vlerë prej 300,000€, rritje nga ndarja e mjeteve me vendime Qeveritare në vlerë 378,713€, si dhe zvogëlim i mjeteve si rezultat i kursimeve me vendime Qeveritare në vlerë 449,246€. Shpenzimi në këtë kategori në raport me buxhetin final ishte 85%.

Buxheti final për shpenzime komunale krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 134,822€. Ky ndryshim ishte rezultat i të hyrave nga donatorët në vlerë 23,500€ dhe zvogëlimit të buxhetit në vlerë 158,322€ me vendime të Qeverisë. Shpenzimi në raport me buxhetin final në këtë kategori ishte 73%.

Buxheti final për subvencione dhe transfere në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur për 9,500,000€. Ky ndryshim ishte rezultat i ndarjes së mjeteve në vlerë 14,300,000€ me vendim të Qeverisë, si dhe zvogëlimit të buxhetit si rezultat i transferit të mjeteve në vlerë 300,000€ në kategorinë mallra dhe shërbime, dhe vendimeve të Qeverisë për kursime në vlerë 4,500,000€. Shpenzimi në raport me buxhetin final në këtë kategori ishte rreth 100%.

Buxheti final për investime kapitale në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 1,200,166€. Ky ndryshim ishte rezultat i fondeve të pranura nga donatorët në vlerë 1,585,502€ si dhe zvogëlimit të buxhetit si rezultat i vendimeve Qeveritare për kursime në vlerë 2,785,668€. Shkalla e realizimit të buxhetit final në këtë kategori ishte 50%. Kjo përqindje jo e kënaqshme vjen si rezultat i një pjese të projekteve të pa-iniciuara, si dhe vonesave në kontraktim dhe realizim të projekteve kapitale.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2024



Të hyrat e realizuara nga MBPZhR në vitin 2024 ishin në vlerë 9,230,661€. Të hyrat kryesisht kanë të bëjnë me inspektime sanitare, fitosanitare dhe veterinare, shfrytëzimi i pronës publike, lëshimi i licencave, të hyrat nga qiraja e tokës së dhënë në shfytëzim etj. Të hyrat tjera kanë të bëjnë me kthime të mjeteve nga viti i kaluar.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Pranimet	2023 Pranimet	2022 Pranimet
Totali i të hyrave	9,791,667	9,791,667	9,230,661	9,384,032	2,570,437
Të hyrat jo tatimore	9,791,667	9,791,667	9,155,452	9,274,321	2,500,467
Të hyrat tjera	0	0	75,210	109,711	69,970

5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2023 të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ka rezultuar me pesë (5) rekomandime.

Ministria kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Ministria për vitin 2024 po ashtu kishte përgatitur një raport periodik për progresin në zbatimin e rekomandimeve ku janë paraqitur veprimet e ndërmarra dhe rezultatet konkrete në lidhje me zbatimin e rekomandimeve.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2024, nga pesë (5) rekomandime të dhëna, dy (2) rekomandime ishin zbatuar, dy (2) rekomandime ishin zbatuar pjesërisht dhe një (1) rekomandim nuk ishte zbatuar.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2023	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Ministri duhet të sigurojë zbatimin e drejtë të kontrolleve të brendshme lidhur me vlerësimin e pronave brenda afatit të përcaktuar me kontratë dhe regjistrimin e drejtë të pasurive jo financiare në pajtim me kriteret e rregullores për menaxhimin e pasurive jo financiare.	Është bërë vlerësimi i pronave dhe janë regjistruar në regjistrin e pasurive. Megjithatë kemi identifikuar pasuri të pa regjistruara edhe këtë vit si dhe mos korrëgjim të vlerave në regjistra për asetet e ri vlerësuar.	Pjesërisht i zbatuar
2.	Baza për opinion	Ministri duhet të sigurojë planifikimin e buxhetit në përputhje me natyrën e projekteve në mënyrë që pagesat të realizohen sipas kategorive ekonomike adekuate, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre në PFV në përputhje me planin kontabël. Nëse planifikimet buxhetore nuk përkojnë me natyrën e shpenzimit dhe nevojat e ministrisë, duhet të bëhet ridestinimi i mjeteve me qëllim të sigurimit të fondeve për pagesën e rregullt të shpenzimeve.	Edhe këtë vit kemi hasur në raste të keqklasifikimit të shpenzimeve. Shpenzimet ishin rezultat i ekzekutimit të shpenzimeve sipas vendimeve gjyqësore.	Nuk ka filluar zbatimin
3.	Baza për konkluzion	Ministri duhet të sigurojë që për të gjitha projektet e pa-përfunduara të aplikohen dëmet e likuiduara si dhe të merren të gjitha masat që parashihen me kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kontratave. Po ashtu, para inicimit të çdo procedure të prokurimit duhet të sigurohet se janë marrë parasysh të gjitha kushtet që e ndikojnë realizimin e projektit përfshirë këtu dizajnin e duhur të projektit, zgjidhjen e problemeve pronësore dhe faktor të tjerë me ndikim.	Janë ndërmarrë masa në aplikimin e ndalesave për vonesa në realizim, por megjithatë projektet nuk janë realizuar në tërësi dhe nuk janë funksionalizuar.	Pjesërisht i zbatuar
4.	Baza për konkluzion	Ministri duhet të gjej një zgjidhje të qëndrueshme në përputhje me kërkesat ligjore lidhur me plotësimin e nevojave të ministrisë për personel shtesë, kështu pozitat e rregullta të punës të përfshihen në planin e rekrutimeve, dhe të sigurohet rekrutimi i personelit të nevojshëm përmes procedurave të rekrutimit në pajtim me detyrat dhe përgjegjësitë e ministrisë.	Nuk ka pasur angazhime të tilla këtë vit.	I zbatuar

5.	Pasuritë	Ministri në bashkëpunim me AUV duhet të ndërmarrë veprime konkrete drejt vënies në përdorim të fabrikës së riciklimit të nën-produkteve me origjinë shtazore. Duke pas parasysh investimin e bërë, duhet ti kushtohet kujdes rrethanave të mundshme të cilat mund të pengojnë vënien në përdorim të këtij projekti.	Me vendim të Kryeministrit është aprovuar dhënia në shfrytëzim e fabrikës për trajtimin e nën-produkteve shtazore. Në janar të vitit 2025 është nënshkruar kontrata me OE si dhe pranim-dorëzimi është bërë në mars të vitit 2025.	I zbatuar
----	----------	---	--	-----------

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Mjellma Dibra, Drejtore e Auditimit



Fjolla Bakalli Sadiku, Udhëheqëse e ekipit



Sabile Muli, Anëtare e ekipit



Valbona Tolaj, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
Nr. Prot. / Prot. No.: 71-05-2023			
Niveli Org. / Org. Unit: 03	Shif. Klasif. / Klasif. Code: 47	Nr. Prot. / Prot. No.: 761	Nr. i Fasove / Br. Stranica No. Pages: 1



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO MINISTERTARI I BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT	
Nr. Akt./No.: 1860	Nr. i Fasove / Br. Stranica No. Pages: 1
Data/Date: 21.05.2023 PRISHTINE - PRISTINA - PRISTINA	

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
 QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVO
 MINISTERTARI I BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
 MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, SUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA
 MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2024 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, për vitin 2024 (në tekstin e mëtejshëm "Raport");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.



Venera Çerçini
 Sekretare e Përgjithshme MBPZHR
 Data: 21.Maj.2025, Prishtinë,

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionin i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionin

Opinionin i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionin i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.